



2 shtator 2025

LETËR SQARUESE

Obligimet e OSHM-ve lidhur me zgjedhjet lokale

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me qëllim të zbatimit të obligimeve ligjore të përcaktuara në Kreun VIII të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me datën 16 dhjetor 2024 ka miratuar Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.

Kjo Rregullore i ka përfshirë dispozitat nga Kreu VIII i Ligjit për Zgjedhjet, si dhe dispozita të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe Rregullores KPM-2023/02 për Komunikimet Komerciale Audio dhe Audiovizuale, të cilat duhet të respektohen.

Përmes kësaj Rregulloreje, OSHM-të duhet të sigurojnë mbulim të fushatës zgjedhore në mënyrë të drejtë dhe të balancuar për të gjitha subjektet politike të certifikuara (SPC).

OSHM-të (**televizionet dhe radiot**) të cilat vendosin të organizojnë programin e tyre gjatë fushatës zgjedhore do të deklarohen tek KPM nëse do të mbulojnë fushatën jo më larg se shtatë (7) ditë kalendarike para fillimit të fushatës zgjedhore. OSHM-të të cilat nuk e njoftojnë KPM-në do të konsiderohen se nuk do ta mbulojnë fushatën zgjedhore (neni 6.2).

OSHM-të obligohen që së paku një (1) javë para fillimit të fushatës zgjedhore të publikojnë orarin, çmimet e ofertuara dhe sasinë e kohës së shitur me pagesë për pikat reklamuese politike me dhe kohën e ofruar pa pagesë për të gjitha subjektet politike të certifikuara dhe të njoftojnë KPM-në (neni 8.3, 9.3 dhe 9.4).

OSHM-të obligohen t'i dorëzojnë ditarët në KPM të hënën e secilës javë për të raportuar për javën paraprake për kohën e emetimit me dhe pa pagesë të reklamimit politik, sipas formave të ditarëve që sigurohen nga KPM-ja (neni 11.2 dhe 11.3), të cilët duhet të plotësohen dhe dërgohen online përmes platformës e-KPM.

OSHM-të gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ofrojnë hapësirë me dhe pa pagesë maksimumi gjashtë (6) orë për të gjitha SPC (neni 9.7), me kufirin sasior 90 minuta për secilin SPC për një ditë (neni 9.9), brenda periudhës prej orës 12:00 deri në 24:00 (neni 6.5).

Debatet politike ku bëhet prezantimi i platformave politike nga subjektet e certifikuara politike organizohen në atë mënyrë ku secili medium e publikon orarin e debateve politike lidhur me temat që do të jenë subjekt i debatit dhe subjekteve politike që do të marrin pjesë (neni 12.1).

Emisionet apo debatet e transmetuara në OSHM gjatë periudhës së fushatës zgjedhore politike nuk do të jenë të sponsorizuara nga subjektet e certifikuara politike apo subjektet tjera (neni 12.7).

OSHM-të në kuadër të programeve informative nuk lejohet të emetojnë asnjë pikë reklamuese politike (neni 6.6).

Pika reklamuese politike nuk mund të jetë më e gjatë se dy (2) minuta (120 sekonda) dhe duhet të identifikohet qartë si e tillë duke treguar qartë organizatën ose individin përgjegjës për të, si dhe nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në përmbajtjet e tyre (neni 7).

OSHM-të gjatë periudhës së fushatës zgjedhore mund të publikojnë sondazhe dhe anketa të opinionit publik bazuar në kriteret e parapara (neni 13.2), ndërsa organizimi, publikimi i sondazheve apo anketave të opinionit publik online, ndalohen (neni 13.1).

OSHM-të, nuk transmetojnë ose publikojnë çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës, gjatë periudhës që fillon me hapjen e vendvotimeve deri në mbylljen zyrtare të tyre (neni 14.1). Rezultatet e hulumtimit të opinionit publik, duke përfshirë daljen në votime, nuk mund të publikohen gjatë periudhës që fillon njëzet e katër (24) orë para mbylljes zyrtare të vendvotimeve dhe deri në përmbylljen e procesit zgjedhor. (neni 13.5). OSHM-të kanë të drejtë transmetojnë vetëm prononcimet e liderëve të partive politike dhe kandidatëve për kryetar të komunës (neni 14.4).

OSHM-të mbulojnë ditën e zgjedhjeve duke raportuar dhe informuar publikun lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, numrin e pjesëmarrësve në zgjedhje, njoftimet zyrtare nga KQZ-ja apo institucionet e tjera relevante, problemet e mundshme apo sjelljet e partive apo pjesëmarrësve në zgjedhje (neni 14.2 dhe 14.3).

Në rastet e ankesave, afati i OSHM-ve për përgjigje në ankesë është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të ankesës (neni 20.4).

KPM kërkon nga të gjithë të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, përfshirë edhe legjislacionin përkatës të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE